



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2023:064614

Datë: 06.11.2023

Numri i dokumentit: 04877492

P.nr.1436/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTIË – DEGA FUSHË KOSOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, sipas Gjyqtares Laura Hoti Statovci, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Albrim Kastrati, në lëndën penale të akuzuarit N. K. nga F. K., i akuzuar për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PP/IL.nr.1761/2023 të datës 27.03.2023, në seancën e shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me datë 27.10.2023, në praninë e Prokurorit të Shtetit Arben Hoti, i akuzuari N. K. dhe mbrojtësja sipas detyrës zyrtare av. Luljeta Jashari Hertica, me datë 31.10.2023 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 06.11.2023 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

N. K., i biri i N dhe nëna H, e gjinisë B, i lindur me ..., në F. K., me vendbanim në L. .. Rr. “Gj...” F. K., me numër personal ..., të dhëna këto të vërtetuara nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, me asistencë sociale, Rom, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 05.12.2022, rreth orës 16:20, në F. K., rrugën “28 N.i” përkatësisht në ... gjersa kishte qenë brenda duke u përkuqjesur për hallën e tij e sëmurë, i pandehuri nga xhaketa e tij i kishte rënë një thikë e kuzhinës në formë të sharrës, me ç ‘rast i njëjti në mënyrë të paautorizuar dhe në kundërshtim me ligjin për armët, ka poseduar dhe mbajtur në pronësi këtë thikë, e cila në bazë të Vërtetimit mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i është sekuestruar të pandehurit.

- *Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par 1 të KPRK-së.*

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 39, 46, 47,48, 69, 70, 71, 72 dhe 248 të KPRK-së dhe neneve 358, 359, 360 dhe 364 të KPPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

- I. Për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par 1 të KPRK-së, të akuzuarit N. K., Gjykata i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën verifikuese prej një (1) viti i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale.
- II. Gjykata në mbështetje të nenit 277 par.1 të KPPRK-së si dhe nenit 366 par.3 të KPRK-së, URDHËRON konfiskimin e përhershëm të armës - thikës.
- III. Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguaj shumën prej 30 (tridhjetë) në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shumën prej 30 (tridhjetë) euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP/II.nr.1761/2023 të datës 27.03.2023, ndaj të akuzuarit N. K. për shkak të dyshimit të bazuar mire se ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Gjykata, në këtë çështje penalo juridike ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 27.10.2023, në prani të Prokurorit të Shtetit, Arben Hoti, të akuzuarit N. K. dhe mbrojtësja e tij sipas detyrës zyrtare av. Luljeta Jashari Hertica, ku i akuzuari pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, e ka pranuar fajësinë për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par 1 të KPRK-së, dhe mbrojtësja e tij ka deklaruar se i mbrojturi im pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtjen dhe pas informimit lidhur me benfitet dhe pasojat e pranimin të fajësisë, i mbrojturi im në mënyrë vullnetare dhe pa presion ka pranuar fajësinë për këtë vepër penale, i propozojnë gjykatës që me rastin e matjes dhe llojit të dënimit ndaj të mbrojturit tim, të shqiptojë një dënim sa më të butë, pasi që i njëjti është hera e parë që bie ndesh me ligjin, shprehë pendimin dhe i premtun gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej vepër penale.

Pas deklarimit të akuzuarit, mendimit të prokurorit se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, nga i pandehuri pasi që një pranim i tillë bëhet në mënyrë vullnetare, i pandehuri është i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë dhe se pranimi i fajësisë është në përputhje të plotë me provat dhe gjendjen faktike të përshkruar si në aktakuzë.

Gjykata konstatoj se i akuzuari e pranon fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, i akuzuari është i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë për të cilat është njoftuar nga Gjykata, , si dhe të gjitha kërkesat nga neni 242 par. 2 të KPPRK-se janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 357 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 242 par. 6 lidhur me par. 2 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të

akuzuarit se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 6 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara si: Raporti fillestar i incidentit me numër 2022-AE-1734 i datës 05.12.2022; Raporti i Policit B. Q. #..., i datës 05.12.2022; Procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin N. K., i datës 05.12.2022, dhënë në Stacionin Policor në Fushë Kosovë; Procesverbali i marrjes në pyetje për dëshmitaren I. H., i datës 05.12.2022, dhënë në ... F. K.; Procesverbali i marrjes në pyetje për dëshmitaren G. B., i datës 05.12.2022, dhënë në ... F. K.; Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i datës 05.12.2022; si foto dhe provat tjera që gjenden të bashkangjitura në lëndë, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, rrjedh se në veprimet e të akuzuarit N. K. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari e ka kryer veprën me dashje, ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarës, kështu që e njëjta është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 të KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për të akuzuarin, gjykata ka vlerësuar faktin se i akuzuari ka treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor duke pranuar fajësinë, duke u ndier i përgjegjshëm për veprimet e tij dhe duke shprehur keqardhje për veprën që e ka kryer. Të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese në dobi të akuzuarit. Ndërsa si rrethanë rënduese ishte fakti se vepra penale ishte kryer me dashje dhe e kaluara e tij kriminale.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjukata në kuptim të nenit 48 të KPRK-se të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjukata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjukata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen veçanërisht llojin e njëjtit të veprës penale, por ai do të ndikojë edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 38 të KPPRK-se.

Duke u bazuar në nenin 449 par. 2 pika 2.6 dhe 452 par.1 të KPPRK-se si dhe në bazë të nenit 36 par.3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit nr.08/L-109, Gjukata ka vendosur për shpenzimet e procedurës penale në shumën e përgjithshme prej 40 Euro.

Konform nenit 366 par.3 të KPRK-së, gjykata ndaj të akuzuarit ka shqiptuar edhe dënimin plotësues ashtu që ka urdhëruar konfiskimin e detyrueshëm e të përhershëm të armës – thikës.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 364 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL**

P.nr.1436/23 më datë 06.11.2023

Bashkëpunëtori Profesional

Gjyqtarja e vetme Gjykuese

Albrim Kastrati

Laura Hoti Statovci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të të njëjtit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.